

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	SHBA qetëson NATO-n: Rusia nuk kërkon konflikt me Aleancën, Evropa të rrisë kapacitetet - Informohu siç duhet
ADRESA	https://radar.al/shba-qeteson-nato-n-rusia-nuk-kerkon-konflikt-me-aleancen-evropa-te-rrise-kapacitetet/
BURIMI	radar.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	23 shtator 2026, 21:05:39 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	23 shtator 2026, 20:40:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	01fe22405dbd6150efafc63574e9e867fab5efc33af1a621923c4f0070cb4488
TEKSTI	b582de8f6da1685f8d359c614503838700edfcf517fa2d76381353a0dcd69d5f
PAMJA	970b5c112c741212b80abf213ca9ff12b0ea78b2c971050189131557bd273562

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	220bf11015dd048159ee6482512f54752242e9b11f6aa90dc9d879c3cda40962
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	9f13708d4cb43333cd442efe7c96fa8554969483459094e5d4825bc5f113135
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/220bf11015dd048159ee6482512f54752242e9b11f6aa90dc9d879c3cda40962>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

YOU ARE AT: Home » SHBA qetëson NATO-n: Rusia nuk kërkon konflikt me Aleancën, Evropa të rrisë kapacitetet

BOTË

Demo

SHBA qetëson NATO-n: Rusia nuk kërkon konflikt me Aleancën, Evropa të rrisë kapacitetet

SEPTEMBER 23, 2026



Shtetet e Bashkuara kanë përcjellë një mesazh qetësues për aleatët e NATO-s lidhur me rrezikun e një përplasjeje të drejtpërdrejtë me Rusinë. Përfaqësuesi i Përhershëm i SHBA-së në NATO, Matthew Whitaker, deklaroi se Moska nuk po kërkon një konflikt me Aleancën e Atlantikut të Veriut, duke paralajmëruar njëkohësisht kundër reagimeve të tepruara ndaj incidenteve të fundit me dronë dhe mjete ajrore ruse në Evropë.

Gjatë një diskutimi të organizuar nga Këshilli i Çikagos për Çështjet Globale në Des Moines, Iowa, Whitaker tha se presidenti rus Vladimir Putin nuk dëshiron një përplasje me NATO-n.

"Presidenti rus Vladimir Putin nuk dëshiron konflikt me NATO-n", u shpreh Whitaker, sipas Associated Press, duke argumentuar se alarmizmi i panevojshëm mund t'u shërbejë kundërshtarëve të Aleancës.

Deklarata e zyrtarit amerikan erdhi në një moment tensioni në Evropë, ndërsa autoritetet polake raportuan se një helikopter rus kishte hyrë për disa minuta në hapësirën ajrore të Polonisë nga drejtimi i enklavës së Kaliningradit. Incidenti shkaktoi reagim të menjëhershëm nga autoritetet e Varshavës.

Në fjalën e tij, Whitaker u ndal edhe te kapacitetet ushtarake të vendeve anëtare të NATO-s. Sipas tij, aftësitë mbrojtëse të disa aleatëve janë dobësuar gjatë dekadave pas përfundimit të Luftës së Ftohtë, si pasojë e bindjes se një konflikt i madh në Evropë nuk ishte më një skenar realist.

"Në thelb, ne kemi nevojë për aleatë me aftësi më të mëdha. Ne kemi nevojë për aleatë që kanë më shumë në arsenalin e tyre", deklaroi ai.

Përfaqësuesi amerikan pranoi gjithashtu se edhe SHBA-ja ka vepruar për një kohë të gjatë nën premisën se do të ishte në gjendje të përballonte njëkohësisht konflikte në dy fronte globale, duke nënvizuar nevojën për një rishikim të kapaciteteve dhe prioritetëve strategjike.

Whitaker bëri të ditur edhe mënyrën se si Uashingtoni i rendit aktualisht prioritetet e tij strategjike. Sipas tij, Evropa ndodhet në vendin e katërt, pas mbrojtjes së territorit amerikan, hemisferës perëndimore dhe rajonit të Paqësorit.

"E katërta është Evropa. Kjo nuk do të thotë që ne po e braktisim Evropën. Ne thjesht po u kërkojmë evropianëve të ndërmarrin veprime dhe të balancojnë situatën", tha ai.

Mesazhi i Whitaker nënvizon kështu njëkohësisht dy qëndrime të Uashingtonit: nga njëra anë, SHBA-ja nuk e paraqet aktualisht Rusinë si një fuqi që po përgatitet për një luftë të drejtpërdrejtë me NATO-n; nga ana tjetër, administrata amerikane po u kërkon aleatëve evropianë të rrisin ndjeshëm kapacitetet e tyre ushtarake dhe të marrin më shumë përgjegjësi për sigurinë e kontinentit.

Postimet e reja

SHBA qetëson NATO-n:
Rusia nuk kërkon konflikt...

SEPTEMBER 23, 2026

Aktorja turke shkëlqen në
Milano Fashion Week,...

SEPTEMBER 23, 2026

Nata e tetë e protestës
"Jo në emrin tim",...

SEPTEMBER 23, 2026

Plagosje me thikë pranë
"Petro Ninit" në Tiranë,...

SEPTEMBER 23, 2026

Mos e humb

FOKUS | SEPTEMBER 22, 2026

Kreditorët te dera, gjykata në kërkim të "Top Fruits" të Ejup Ahmetit dhe Marin Gjonajt: Paraqituni në gjyq

Situata financiare e një prej ish-gjigantëve të grumbullimit dhe eksportit të fruta perimeve, "Top Fruits",...

Kompania e krijuar tri ditë pas hapjes së thirrjes për grantet e startupeve fitoi 6.1 milionë lekë në fazën e rezervuar për bizneset të paktën 1-vjeçare

Skema sesi IUTE zbras fitimin nga Shqipëria, që ju merr konsumatorëve me interesa mbi 30%!

Skandal me sallamin në dyqanet Conad, thirrje konsumatorëve ta kthejnë mbrapsht

Na ndiq

Deklaratat vijnë në një periudhë kur incidentet me mjete ajrore ruse pranë ose brenda hapësirës ajrore të vendeve të NATO-s kanë shtuar shqetësimet për sigurinë evropiane, ndërsa aleatët vazhdojnë të diskutojnë mënyrat për forcimin e mbrojtjes së përbashkët.

nato SHBA

SHARE.

Facebook

Instagram

YouTube

TikTok

RRETH NESH



Një shikim i thellë në botën e lajmeve, ku teknologjia dhe profesionalizmi takohen për të sjellë lajmet më të fundit dhe të rëndësishme brenda dhe jashtë Shqipërisë. Një burim i besueshëm për informacionin e saktë dhe analizat gjithëpërfshirëse.

NIPT: M47705501A

Email: radarlajme@gmail.com

Kontakt: +355689008000

HOROSKOPI

Njohje të reja për beqarët,
mundësi fitimi dhe sfida në punë,
çfarë thonë yjet për ju sot

Universi ka një surprizë për këto 3
shenja më 14 shtator

Një ditë me surpriza në dashuri:
Horoskopi për të gjitha shenjat



Aleanca për
Media
Etike

Artikull joetik?

raporto këtu

© Radar.al. dizenuar nga 1001solutions

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.